




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE



Nr. 18652/1 Prot.

Tiranë, më 25 / 7 / 2019


Lënda: Dërgim shkresë

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
DEGËS DOGANORE FIER ✓

Bashkëlidhur po Ju përcjellim shkresën Nr. 18652 Prot., datë 17.07.2019, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me objekt "Kërkesë për pezullim veprimësia" në lidhje me problematikën e shoqërisë "Bankers Petroleum Albania".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Zv/DREJTOR I PERGJITHSHEM



Sulejmani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 7802 Prot.

Tiranë, më 17.12.2019

Lënda: Kërkesë për pezullim veprimesh

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Tiranë

Bankers Petroleum Albania Ltd (BPAL), kryen aktivitetin e vet në bazë të Marrëveshjes për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në zonën Patos-Marinzës, marrëveshje e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.477 datë 16.07.2004, "Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinzë" (e ndryshuar me VKM nr.51, datë 12.3.2009, dhe me VKM.nr. 725, datë 02.11.2014).

Referuar përcaktimeve të kësaj marrëveshje, si dhe marrëveshjeve të tjera të së njëjtës natyre, si dhe duke konsideruar edhe eksperiencën e deritanishme në këtë fushë, rezulton se, nuk ka normative të përcaktuara për sasinë e holluesit që mund të përdoret në proceset mineralogjike dhe teknologjike të nxjerrjes së naftës bruto nga nëntoka. Normativa e holluesit ndryshon sipas llojit të naftës bruto në shtresë kryesisht densitetit të saj, presionit të shtresës dhe temperaturës në të, gjendjes fiziko-dinamike të shtresës ku është depozituar në mënyrë natyrale nafta bruto, teknologjisë së përdorur për nxjerrjen e saj, si edhe parametrave të tjerë të lidhur me trajtimin e naftës bruto nga gryka e pusit deri në pikën e lëvrimit/shitjes, si kundër është temperatura e fluidit, lloji i transportit etj. Thëksojmë se proceset gjatë nxjerrjes dhe transportimit, janë fizike por edhe me natyrë kimike (nafta bruto përzihet në mënyrë uniforme me holluesin që injektohet në nëntokë, në shtresë, në procesin e nxjerrjes së saj).

Sqarimi i detajuar mbi natyrën e materialit hollues, bëhet me qëllimin për të kuptuar se pretendimet e ngritura në vite lidhur me abuzimet në sasinë e përdorur nga BPAL dhe të tjerë operatorë të prodhimit të naftës bruto, mund të verifikohen dhe të konsiderohen si të vërteta, vetëm pasi të jenë bërë më parë, analiza kimike dhe fizike të naftës bruto të nxjerrë nga nëntoka me holluesin brendë saj; analiza të naftës gjendje në shtresë pa përdorur holluesin; analiza e naftës bruto në pikat e dekantimit (e dekantuar nga përbërës ose fluide të tjera jo të trupëzuara në naftë bruto), si edhe analiza të naftës bruto në pikën e lëvrimit për të verifikuar bilancin sasior të përdorimit të holluesve

dhe lëndëve të tjera kimike të përdorura në procesin e nxjerrjes dhe transportit të lëngut është fakt që këto analiza nuk janë bërë asnjëherë, për të konkluduar lidhur me sasinë e holluesit të përdorur.

Sa i përket rastit në fjalë, konkretisht pretendimit të Doganës Fier për detyrimin e BPAL për të paguar akcizë për holluesin e përdorur, pretendim i cili në fakt ka të bëjë më shumë, me shkeljen (verifikuar nga dogana) në procesin e lëvrimin të holluesit nga magazina me regjim doganor pa akcizë, në paset ku nxirret nafta bruto dhe injektohet holluesi. Mendojmë se masat e marra duhet të jenë masa administrative referuar procedurave doganore, e jo masa në lidhje me detyrimin sipas ligjit 61/2012 "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë".

Theksojmë se në nenin 4, pika 1 të ligjit nr.61/2012, "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet qartazi, rasti kur lind detyrimi për pagesën e akcizës për mallrat e klasifikuara sipas Nomenklaturës Doganore "Për mallrat e akcizës". Konkretisht, detyrimi lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor. Pra është e qartë se duhet të verifikohet konsumi i tyre në territor që të mund të tatohen me akcizë. Në rastin e përdorimit të holluesit nga BPAL dhe operatorë të tjerë për arsye mineralogjike dhe tekno-kimike nuk verifikohet konsumi i tij as si konsum në vetrete, por as si konsum si lëndë djegëse, pra si mall akcize.

Gjithashtu, në nenin 10, pika 3 germën (a) dhe (c) të këtij ligji përcaktohen rastet kur përjashtohen nga detyrimi për pagimin e akcizës. Konkretisht, neni 10, pika 3 germën (a) parashikon se përjashtohen nga pagimi i akcizës "Produktet e akcizës që eksportohen" dhe në rastin konkret në pjesë e rëndësishme e naftës bruto që përmban holluesin e përdorur të trupëzuar kimikisht eksportohet, pra nuk është subjekt akcize. Ndërsa në nenin 10, pika 3 germën (c) parashikohet se përjashtohen nga pagimi i akcizës "Produktet energjetike me përdorim të dyfishtë. Në produkt është me përdorim të dyfishtë kur është i destinuar njëkohësisht si lëndë djegëse dhe për përdorim të ndryshëm nga ai i karburanteve, ose i lëndëve djegëse. Përdorimi i produkteve energjetike për reduktimin kimik dhe elektrolizën, si edhe procese metalurgjike konsiderohen si një përdorim i dyfishtë". Në rastin konkret jemi në kushtet kur holluesi nuk përdoret si karburant, por as si lëndë djegëse. Për më tepër, për shkak të proceseve teknologjike në thellësi të shtresës ku ndodhet nafta bruto, holluesi bashkohet nën një proces kimik me produktin e së njëjtës natyrë dhe mbartës natyror i fraksioneve më të lehta të çdo holluesi të përdorur në këtë proces që është vetë nafta bruto. Kështu nafta bruto që nxjerrim nga nëntoka, nuk e konsumon holluesin por e mbart atë brenda saj në sasi dhe cilësi. Po kështu në vijim në germën (ç) të po kësaj pike përcaktohen edhe "Produkte energjetike të përdorura në procese mineralogjike" – pikërisht ky rast në mënyrë të shprehur qartëson se holluesi i përdorur për nxjerrjen e naftës bruto nga nëntoka, përjashtohet nga pagesa e akcizës. Në këtë kontekst, holluesit nuk janë mallra akcize, por as konsumohen në rast se klasifikohen si të tillë.

Duke iu referuar sa më sipër ligjit, i cili përcakton qartazi se kur lind detyrimi për akcizë, kush janë mallrat subjekt akcize, dhe në cilat raste ato përjashtohen kategorikisht nga detyrimi i akcizës,


theksojmë edhe një herë se vendimi i Drejtorisë së Doganave për nxjerrjen e detyrimit për të paguar akcizë për halluesin dhe gjoba për shmangien nga ky detyrim nuk qëndron, dhe është i padrejtë.

Nga sa më lart, parashtrojmë kërkesën institucionale, për të konsideruar sa më sipër si dhe kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave të pezullojë të gjithë veprimet lidhur me këtë çështje, pra të pezullojë finalizimin dhe njoftimin final të këtij penaliteti, deri në marrjen e një interpretimi ligjor nga Gjykata Kushtetuese mbi ligjshmërinë e këtij akti. Mendojmë se ky është një veprim domosdoshëm për të mos gabuar në vlerësim të situatës. Sjellim në vëmendje se në një çështje të së njëjtës natyre kemi humbur procesin me BPAL për shumën 4.022 miliard lekë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Me respekt,

MINISTËR


Belinda Balluku

